UDHËZIM
Nr. 2, datë 17. 2.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.15, DATË 16.7.2003 "PËR PROCEDURAT E HAPJES DHE MBYLLJES SË SALLAVE TË LOJËRAVE ARITMETIKE, ELEKTRONIKE DHE PIKAVE TË LOJËRAVE TË FATIT SPORTIVE"

Në mbështetje të nenit 102/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet” dhe në zbatim të nenit 1 pika 2 të vendimit nr.238, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së lejes për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet” Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në pikën 1 germa "a" të udhëzimit nr.15, datë 16.7.2003 fjala "kërkesë" zëvendësohet me fjalën "njoftim".

2. Në pikën 2 germa "a" të udhëzimit nr.15, datë 16.7.2003 fjala "kërkesë" zëvendësohet me fjalën "njoftim".

3. Në pikën 3 germa "a" të udhëzimit nr.15, datë 16.7.2003 fjala "kërkesë" zëvendësohet me fjalën "njoftim".

4. Pika 5 e udhëzimit nr.15, datë 16.7.2003 ndryshon si më poshtë:

"Vetëm për shoqëri të licencuara në lojëra fati, për transferimin e automatëve të certifikuar dhe të miratuar, në rastet e shtimit ose heqjen e automatëve të rinj në sallat ekzistuese, detyrohen të njoftojnë Drejtorinë e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve pranë Ministrisë së Financave.".

5. Pika 6 e udhëzimit nr.15, datë 16.7.2003 ndryshon si më poshtë:

“Shoqëritë e lojërave të fatit detyrohen të njoftojnë me të njëjtën shkresë Drejtorinë e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, degën e tatim-taksave të rrethit përkatës, 15 ditë përpara hapjes së sallave, pikave të basteve sportive, për transferimin, shtimin dhe heqjen e automatëve elektronikë.".

6. Pika 7 e udhëzimit nr.15, datë 16.7.2003 ndryshon si më poshtë:

Verifikimi i hapjes së sallave, pikave të basteve sportive, si dhe transferimi, shtimi ose heqja e automatëve elektronikë kryhet nga ana e Policisë Tatimore. Akti i verifikimit do të dërgohet në Drejtorinë e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve brenda 15 ditëve nga data e deklarimit të tyre.

"Në rast se shoqëritë e lojërave të fatit nuk paraqesin dokumentacionin e parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të udhëzimit, nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë pa e plotësuar këtë dokumentacion sipas kërkesave të këtij udhëzimi".

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTËRI I FINANCAVE
Arben Malaj